



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
BORDI DISIPLINOR**

Nr. (•)Vendimi

Tiranë, më (•)

V E N D I M

BORDIT DISIPLINOR I DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERISË

i përbërë nga :

Jonida Gaba:	Kryetare
Entela Memishaj Shehaj:	Sekretar/Anëtar
Irena Laha:	Anëtar
Marjana Tutulani Semini:	Anëtar
Merita Prifti:	Anëtar

në mbledhjen e mbajtur më datë (•), mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me të dhënat si më poshtë:

OBJEKTI: Pezullimi nga detyra i noteres (•)

BAZA LIGJORE: Neni 56, shkronja "a", nenet 57, 58, 59, pika 1, dhe 60 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", i ndryshuar.

BORDI DISIPLINOR

- pas marrjes dijeni nga mediat audiovizive për arrestimin nga Policia e Shtetit të noteres (•), iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (•) me kërkesën për informacion zyrtar në lidhje me caktimin e masës së sigurimit personal ndaj noteres (•), sipas shkresës nr. (•), datë (•);
- më datë (•), administroi kërkesën e Ministrisë të Drejtësisë nr. (•) Prot., datë (•) për informim/kërkesë për pezullimin e noteres (•), e cila nuk përmbante të dhëna zyrtare a dokumtacion lidhur me caktimin nga gjykata të masës së sigurimit personal ndaj noteres (•);
- më datë (•), administroi informacionin zyrtar nga autoritetet përgjegjëse lidhur me caktimin a masës së sigurimit "arrest në burg", konkretisht, shkresën nr.(•)Prot., datë (•) të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me lëndë "Përgjigje tuajës nr. (•)Prot., datë (•)" përmes së cilës i përcillen Bordit Disiplinor Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si vijon: vendimi nr. (•) Akti, datë (•) për caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" ndaj personit në hetim (•) për kryerjen e veprës penale "Vjedhje duke shpërdoruar detyrën" e parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal si dhe Vendimin nr. (•)Akti, datë (•) për vazhdimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" ndaj personit nën hetim (•);
- pasi administroi në dosje edhe njoftimin në faqen e Gjykatës së Apelit (•) lidhur me vendimin nr. (•), datë (•) për miratimin e vendimit nr. (•)Akti, datë (•) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe

- duke marrë në konsideratë edhe kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për pezullimin e noteres (•), sipas shkresës së sipërcituar nr. (•) Prot., datë (•);

bazuar në nenet 56 – 60 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”,

VENDOSI:

1. Pezullimin nga detyra të noteres (•), Notere e Dhomës së Noterisë (•), për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit “arrest në burg”, në bazë të nenit 56, shkronja “a”, të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”;
2. Vendimi i njoftohet noteres (•) dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (•);
3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë për publikimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në regjistrin përkatës;
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatën kompetente administrative të shkallës së parë Tiranë, brenda 45 diteve nga e nesërmyja e njoftimit të tij;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë (•), në Tiranë.

Bordi Disiplinor:

Jonida Gaba

Entela Memishaj Shehaj

Irena Laha

Marjana Tutulani Semini

Merita Prifti